



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

26.05.2014

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Shtyhet shitja e Njësisë nr. 52 Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (LOT C), Ferizaj nga Shitja përmes Likuidimit 26.

Ndërsa nga VALA e 60, shtyhet shitja e:

Ndërmarrja e re “Tokë bujqësore Ratar Çagllavicë I sh.p.k.”

Ndërmarrja e re “Tokë bujqësore Ratar Çagllavicë II sh.p.k.” -

Ndërmarrja e re “Ratar Prsihtinë sh.p.k.”

Ndërmarrja e re “Ratar Graqanicë sh.p.k.”

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka shtyer shitjen e Njësinë nr. 52: Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (LOT C) dhe ndërmarrjeve si me poshtë:

Ndërmarrja e re “Tokë bujqësore Ratar Çagllavicë I sh.p.k.”

Ndërmarrja e re “Tokë bujqësore Ratar Çagllavicë II sh.p.k.” -

Ndërmarrja e re “Ratar Prsihtinë sh.p.k.”

Ndërmarrja e re “Ratar Graqanicë sh.p.k.”

Ky aset dhe këto Ndërmarrje ishin paraparë për tu shitur përmes shitjes së asetëve nr. 26, dhe Valës 60 të privatizimit që do të mbahet me datë 10 qershor 2014.

Afati i fundit për para-kualifikim për të marrë pjesë në tenderin e shitjes së asetëve në likuidim nr. 26 dhe Valës 60 të privatizimit është data 3 qershor 2014. Dita për dorëzimin e ofertave për asetet dhe ndërmarrjet në vijim është 10 qershor 2014, nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë duke filluar nga ora 12:30.

Në vazhdim mund të gjeni të bashkangjitur listën e plotë të asetëve dhe ndërmarrjeve të parapara për shitje përmes Likuidimit Nr. 26 dhe Valës 60 të privatizimit:

VALA 60 E PRIVATIZIMIT

Ndërmarrja e Re Agromorava Toka në Sadovinë të Jerlive (Lot A) Sh.P.K. - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 13ha 90ari 81m², në zonën kadastrale Sadovina e Jerlive, Komuna e Vitisë, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

Ndërmarrja e Re Agromorava Toka në Sadovinë të Jerlive (Lot B) Sh.P.K. - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 27ha 33ari 99m²,

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

në zonën kadastrale Sadovina e Jerlive, Komuna e Vitisë, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

Ndërmarrja e Re Fapol SH.P.K. - ofron për shitje fabrikën për prodhimin dhe përpunimin e masave të poliesterit në Podujevë. Objektet kryesore të fabrikës ku hyjnë disa halla prodhimi, depo të ndryshme, ndërtesa administrative etj, kanë një sipërfaqe totale prej përafërsisht 11,577 m², si dhe objektet tjera përcjellëse si trafo, restoranti, ngrohtorja etj, kanë një sipërfaqe totale prej përafërsisht prej 1,761 m². Ndërmarrja e re shtrihet në zonën kadastrale Podujevë, rr. "Zahir Pajaziti" nr.196, afër kryqëzimit të magjstrales Podujevë - Prishtinë. Ndërmarrja e re përfshinë vetëm objektet e lartcekura, dhe nuk përfshinë tokë e cila do të transferohet.

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 5 – Toka Bujqësore në Novakë SH.P.K. - ofron për shitje tokën bujqësore (vreshta jo aktive) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 49 ha 38 ari 70 m² (493870 m²).

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 6 – Toka Bujqësore në Novakë SH.P.K. - ofron për shitje tokën bujqësore (vreshta jo aktive) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 32 ha 72 ari 70 m² (327270 m²).

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 7 – Toka Bujqësore në Novakë SH.P.K. - ofron për shitje tokën bujqësore (vreshta jo aktive) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 15 ha 89 ari 25m² (158925 m²).

Ndërmarrja e Re Lavërtaria-Blegtoria "Administrata Kryesore" Prizren SH.P.K. - ofron për shitje sipërfaqen e përgjithshme prej 2,091m² (20ari 91 m²), prej të cilave 725m² është ndërtesë e tipit bodrum me përdhese si dhe 1,366m² oborr.

Vërejtje: Prona ku ndodhen shkallët për qasje në bodrumin e Ndërmarrjes së Re lëndë e shitjes, NUK është pjesë e shitjes pasi që kjo pronë është privatizuar me Ndërmarrjen e Re "Industria Ushqimore" SH.P.K. në valën e 48 të privatizimit.

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 – Toka Bujqësore në Smaq SH.P.K. - ofron për shitje tokën bujqësore (vreshta jo aktive) me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 18 ha 35 ari 20 m² (183520 m²)

Ndërmarrja e Re Agromorava Toka Bujqësore në Tërstenik Sh.P.K - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 66ha 24ari 05m², në zonën kadastrale Sadovina e Çerkezve, Komuna e Vitisë, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

SHITJA 26 E ASETVE TE NDERMARRJEVE NE LIKUIDIM

Njësia nr.1: KB Përparimi Parkingu - ofron për shitje tokën urbane me sipërfaqe përafërsisht 2,650m² (26ari 50m²) si dhe lokalin afarist me dy kate në sipërfaqe totale prej përafërsisht 200m², i cili gjenden në këtë tokë. Aseti gjendet në një pjesë mjaft atraktive të qendrës së Podujevës.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Njësia nr.2: Rilindja Libraria nr.2, Prishtinë - ofron për shitje tokë me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 150m² (1ari 50m²) dhe ndërtesën dy kate (P+1). Bazuar në matjet në terren sipërfaqja totale e objektit është përafërsisht 327.64m² (kati përdhes me sipërfaqe prej 227.24m² dhe nënkulmi me sipërfaqe prej 100.40m²). Ky aset gjendet në Rr.Zenel Salihu nr.4 Prishtinë, afër Gjykatës Themelore Prishtinë.

Njësia nr.3: Rilindja Libraria nr.3 Prishtinë - ofron për shitje lokal in afarist me sipërfaqe përafërsisht 47.32m², i cili gjendet në Rr. Imzot Nikëprela, Prishtinë, dhe ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.4: Rilindja Libraria nr.4 Podujevë - ofron për shitje lokal in afarist me sipërfaqe përafërsisht 77m² bruto, i cili gjendet në Rr. Zahir Pajaziti Podujevë dhe ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.5: Llapi Shitorja 5 - ofron për shitje shitoren me sipërfaqe prej përafërsisht 34m². Lokali afarist gjendet në Rr.Skenderbeu në qendër të Podujevës. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.6: Llapi Shitorja 6 - ofron për shitje shitoren me sipërfaqe prej përafërsisht 34m². Lokali afarist gjendet në Rr.Skenderbeu në qendër të Podujevës. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.7: Llapi Shitorja nr.10 - ofron për shitje lokal in afarist i cili, sipas matjeve në terren, ka sipërfaqje prej përafërsisht 43m² kurse, sipas listës së aseteve të Ndërmarrjes, sipërfaqja është përafërsisht 46m². Lokali gjendet në Rr. Skënderbeu, në qendër të Podujevës. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.8: Llapi Shitorja 19 - ofron për shitje lokal in afarist i cili, sipas matjeve në terren, ka sipërfaqje prej përafërsisht 27.80m², kurse, sipas listës së aseteve të Ndërmarrjes, sipërfaqja është përafërsisht 26m². Lokali afarist është i karakterit të përkohshëm dhe gjendet në Rr. Ilir Konushevc i në qendër të Podujevës. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.9: Llapi Shitorja 25 – ofron për shitje lokal in afarist e cila sipas gjendjes faktike është përafërsisht 56.75m² kurse sipas listës së aseteve të ndërmarrjes është me sipërfaqe përafërsisht 54m². Lokali gjendet në Rr. “28 Nëntori” në qendër të Podujevës. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.10: Barnatorja Pozharan - ofron për shitje lokal in afarist, i cili në bazë të matjeve në terren përfshinë sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 51m². Lokali gjendet afër Stacionit Policor dhe Ambulancës në Fsh. Pozharan, Komuna e Vitisë. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Rr. Ilir Konushevc i No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Njësia nr.11: Kosovarja Artizanati Zyra Administrative - ofron për shitje lokal in afarist me sipërfaqe të përgjithshme bruto prej përafërsisht 509m², nga të cilat përdhesë me sipërfaqe bruto përafërsisht 291.3m² dhe kati i parë me sipërfaqe bruto përafërsisht 217.7m². Kosovarja Artizanati Zyra Administrative, gjendet në pjesë atraktive të qytetit të Prishtinës rrugën Tirana nr.5A afër bulevardit Bill Clinton. Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.12 – Goleshi tokë – ofron për shitje tokën në sipërfaqe prej afërsisht 20928m² (2ha 09ari 28m²) në ngastrën kadastrale 341 në ZK Medevc; me sipërfaqe 26136m² (2ha 61ari 36m²) që gjendet në fshatin Medevc, Komuna Lipjan, Hekurudha nuk është për shitje dhe nuk do t'i bartet blerësit. Sipërfaqja e tenderuar mund të ndryshojë pas paralizimit.

Njësia 13: LUX Dyqani Elektrotehnika në veri të Mitrovicës - ofron për shitje dyqanin me sipërfaqe rreth 60m², i cili gjendet në rrugën “Kralj Petar I” në Mitrovicë veriore. Këto të dhëna janë marrë nga dokumenti-lista e aseteve të Ndërmarrjes, pasi që ne nuk kemi dokumente tjera as qasje në pronën e cila do të tenderohet.

Njësia 14: LUX Dyqani Ibar 3 në veri të Mitrovicës - ofron për shitje dyqanin me sipërfaqe rreth 85.56m², i cili gjendet në rrugën “Vlade Cetković” në Mitrovicë veriore. Meqenëse nuk kemi të dhëna rreth sipërfaqes nga lista e aseteve të Ndërmarrjes, sipërfaqja është dhënë në bazë të matjeve në teren.

Njësia 15: LUX Dyqani Lirija në veri të Mitrovicës - ofron për shitje dyqanin me sipërfaqe rreth 70m², i cili gjendet në rrugën “Kolashinit” afër urës kryesore mbi lumin Ibër. Këto të dhëna janë marrë nga dokumenti-lista e aseteve të Ndërmarrjes, pasi që ne nuk kemi dokumente tjera as qasje në pronën e cila do të tenderohet.

Njësia 16: Depot e parcelat e Lux dhe parcelat e IMB - ofron për shitje depot e parcelat e Lux dhe parcelat e IMB, ku depot kanë sipërfaqe të përgjithshme prej 4,548.48m² sipas Geo medias, ndërsa parcelat kanë sipërfaqe të përgjithshme prej 4,387m², sipas Çertifikatave të pronës, me vendndodhje në ish Zonën Industriale në Mitrovicë.

Njësia 17: Çyçavica Vetëshërbimi i Vjetër - ofron për shitje Vetëshërbimin e Vjetër të Çyçavices me sipërfaqe prej 130m², sipas listës së aseteve, ndërsa sipas matjeve në teren sipërfaqja është 136.80m², e cila gjendet në ndërtesën afaristebanesore bashkangjitur me Shtëpinë e Mallrave në rrugën “Adem Jashari” në qendër të Vushtrrisë.

Njësia 18: Transkosova Tokë Zhabarë i Epërm – ofron për shitje tokën me sipërfaqe përafërsisht prej 1,596m² (15ari 96m²) e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Zhabari i Epërm, Mitrovicë.

Njësia 19: Elan Toka në ZK Muhaxher (Studime) e Epërme - ofron në shitje tokën në Muhaxher (Studime) e Epërme me sipërfaqe rreth 8ha 15ari 12m² (81512 m²).

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Njësia 20: NBI Rahoveci Prona në Nushpallë 2 - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 7ha 68ari 28m² (76828m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Nushpallë, Komuna e Rahovecit.

Njësia 21: NBI Rahoveci Prona në Prona në Polluzhë 2 - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 15ha 53ari 08m² (155308m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Polluzhë, Komuna e Rahovecit.

Njësia 22: NBI Rahoveci Prona në Çifllak 2 - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 3ha 66ari 47m² (36647m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Çifllak, Komuna e Rahovecit.

Njësia 23: NBI Rahoveci Prona në Gexhë 4 - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 52ari 52m² (5252m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Gexhë, Komuna e Rahovecit.

Njësia 24 NBI Rahoveci Prona në Xërxe 7 - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 57ari 31m² (5731m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Xërxe, Komuna e Rahovecit.

Njësia 25: NBI Rahoveci – Prona në Dobidol 1 - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 82 ari 68 m² (8268 m²) e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Dobidol, Komuna e Rahovecit.

Njësia 26: NBI Rahoveci – Prona në Dejnë 2 - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 2 ha 39ari 54 m² (23954 m²) në Zonën Kadastrale Dejnë, KK Rahovec.

Njësia 27: NBI Rahoveci – Prona në Optrushë 6, Rahovec - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 1 ha 34ari 16m² (13416 m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Optrushë, KK Rahovec.

Njësia 28: NSH “Koritniku” – Trualli në fshatin Brod, Dragash - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 26 m² që ndodhet në Zonën Kadastrale Brod, KK Dragash.

Njësia 29: NSH “Koritniku”- Trualli në Dragash - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 3 ari 49 m² (349 m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Dragash, Komuna e Dragashit.

Njësia 30: NSH “Koritniku” - Shitorja në Gllboçicë, Dragash - ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 59 m², prej të cilave 28 m² me kulturë “ndërtesë” ndërsa 31 m² me kulturë oborr, sipas dokumenteve pronësore. Shitorja ndodhet në fshatin Gllboçicë, Komuna e Dragashit. Shënim për ndërtesën: Sipas gjendjes në terren shitorja është e tipit P+1 me sipërfaqe të përgjithshme (42m² +42m²) prej 84 m². Ndryshimet/zgjerimet në ndërtesë nuk janë të regjistruara në ZKK Dragash prandaj i regjistruar është vetëm gabariti i ndërtesës pa sipërfaqe të kateve.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Njësia 31: NSH NB Mirusha – Prona në Bubavec 1 - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 61 ha 96 ari 14 m² (619614 m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Bubavec, Komuna e Malishevës.

Njësia 32: NSH NB Mirusha – Prona në Bubavec 2 - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme prej 22 ha 91 ari 62 m² (229162 m²) që ndodhet në Zonën Kadastrale Bubavec, Komuna e Malishevës.

Njësia 33: NSH NB Mirusha – Prona në Damanek 1 - ofron për shitje tokën që ndodhet në Zonën Kadastrale Damanek me sipërfaqe të përgjithshme prej 7 ha 59 ari 40 m² (75940 m²), Komuna e Malishevës.

Njësia 34: NSH Kooperativa Shtërpçë – Ndërtesa e Administratës në Shtërpçë - ofron për shitje pronën me sipërfaqen e përgjithshme prej 5ari 28m² (528m²), nga e cila, sipas dokumenteve zyrtare pronësore, ndërtesa evidentohet me gabarit 217m² dhe oborri/toka me sipërfaqe prej 311m² . Prona ndodhet në Zonën Kadastrale Shtërpçe-Komuna Shtërpçe. Vërejtje: Sipas gjendjes në terren prona përfshinë ndërtesën e cila përmban bodrumin, përdheshën dhe katin e parë (B+P+1). Sipas matjeve interne dhe jozyrtare sipërfaqja e gabarimit është rreth 200m², ndërsa sipërfaqja e ndërtesës administrative është përafërsisht 580m² (B=180m²; P=200 m²; K1=200m²).

Njësia nr. 35: NSH Mofast Objekti i Administratës - ofron për shitje objektin administrativ (B+P+1) me sipërfaqe totale 405.34m² (sipas matjeve në terren) si dhe ngastrat nr. 1249-1 dhe 1249-2 me sipërfaqe totale 8ari dhe 26m² (826 m²). 2 Aseti gjendet ne Rr. Ali Pashë Tepelena, Komuna Pejë. Në dokumentet kadastrale baza e objektit ka sipërfaqen prej 196 m².

Njësia nr. 36: NT Koreniku Supermarket nr. 1 afër KEDS, Istog - ofron për shitje lokalit etazh me sipërfaqe të përafërt 146m² sipas listës së aseteve të Ndërmarrjes (149m² sipas matjeve në teren) që gjendet në katin përdhesh të një objekti banesor afër KEDS në qytetin e Istog-ut. Toka ku ndodhet dyqani NUK është pjesë e kësaj shitje.

Njësia nr. 37: Dyqani nr. 25 në Rr. Fadil Ferati, Istog - ofron për shitje dyqanin etazh me sipërfaqe të përafërt 28m² sipas listës së aseteve (31m² sipas matjeve në terren) dhe që gjendet në katin përdhesh të një objekti banesor në rrugën Fadil Ferati në qytetin e Istogut. Toka ku ndodhet dyqani NUK është pjesë e kësaj shitje.

Njësia nr. 38: Dyqani nr. 1 në Banjë përballë Postës - ofron për shitje dyqanin etazh me sipërfaqe të përafërt 45m² sipas listës së aseteve (64m² sipas matjeve në teren). Lokali gjendet në katin përdhesh të një objekti banesor në Banjë të Pejës, përballë postës. Toka ku ndodhet dyqani NUK është pjesë e kësaj shitje.

Njësia nr. 39: Dyqani nr. 3 në Banjë përballë Postës - ofron për shitje dyqanin etazh me sipërfaqe të përafërt 40m² sipas listës së aseteve (50m² sipas matjeve në teren). Lokali gjendet në katin përdhesh të një objekti



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

banesor në Banjë të Pejës, përballë postes, Komuna Istog. Toka ku ndodhet dyqani NUK është pjesë e kësaj shitje.

Njësia nr. 40: Dyqani nr.541/2 në Rr. Dëshmorët e Kombit, Klinë - ofron për shitje dyqanin etazh me sipërfaqe të përafërt 69m² që gjendet në katin përdhësë të një objekti banesor në rrugën Dëshmorët e Kombit në Komunën Klinë. Toka ku ndodhet dyqani NUK është pjesë e kësaj shitje.

Njësia nr. 41: Dyqani nr.541/3 Rr. Dëshmorët e Kombit, Klinë – ofron për shitje dyqanin etazh me sipërfaqe të përafërt 66² që gjendet në katin përdhësë të një objekti banesor në Rr. Dëshmorët e Kombit në Komunën Klinë. Toka ku ndodhet dyqani NUK është pjesë e kësaj shitje.

Njësia nr. 42: KB Shtupel Toka Bujqësore në Shtupel 1 - ofron për shitje tokën bujqësore të regjistruar në ngastrat kadastrale nr. 6/19, 6/20 dhe 6/22 me sipërfaqe totale 39363m² (3ha 93ari dhe 63m²) të cilat ndodhen në ZK Shtupel, Komuna Klinë.

Njësia nr. 43: KB Shtupel Toka Bujqësore në Shtupel 2 - ofron për shitje tokën bujqësore të regjistruar në ngastrat kadastrale nr. 175 dhe 183 me sipërfaqe totale 9220m² (92ari dhe 20m²) të cilat ndodhen në ZK Shtupel, Komuna Klinë.

Njësia nr.44: NSH Emin Duraku Dyqani nr. 1 afër Gjmnazit në Gjakovë - ofron për shitje lokalin B+P me sipërfaqe të përafërt 571m² i cili ndodhet në bazën dhe katin përdhësë të objektit banesor në rr. Marin Barleti, Komuna Gjakovë. Toka NUK është pjesë e shitjes.

Njësia nr.45: NSH Emin Duraku Dyqani nr.3 (ish-radio Besa) afër Gjmnazit në Gjakovë - ofron për shitje lokalin P+1 me sipërfaqe të përafërt 93m² i cili ndodhet në katin përdhësë dhe në katin e parë të objektit banesor në Rr. Marin Barleti, Komuna Gjakovë. Toka NUK është pjesë e shitjes.

Njësia nr. 46: NSH Emin Duraku Dyqani nr. 2 afër Gjmnazit në Gjakovë - ofron për shitje lokalin P+1 me sipërfaqe të përafërt 687m² i cili ndodhet në katin përdhësë dhe katin e parë të objektit banesor në rr. “Marin Barleti”, Komuna Gjakovë. Toka NUK është pjesë e shitjes.

Njësia nr.47: KB Liria Objekti i Vjetër i Administratës në Jagodë - ofron për shitje /tokën në sipërfaqe reth 38 ari dhe 64m² (3864m²) që ndodhet në ZK Jagodë, Komuna Klinë. Në shitje gjithashtu përfshihet edhe objekti P+1 në sipërfaqe të përafërt prej 1,124m² sipas të dhënave kadastrale, i përbërë nga kati përdhësë në sipërfaqe prej 562m² dhe kati i parë prej 562m². Objekti nuk është në gjendje të mirë.

Njësia nr. 48: NSH Pejaturist Objekti në Korzë Pejë - përbëhet nga lokali me sipërfaqe 95m² sipas të dhënave kadastrale (93m² sipas matjeve në terren) si dhe toka ku gjendet lokali me sipërfaqe totale 95m², e regjistruar ne ngastrat kadastrale nr. 2268 dhe 2264-2. Dyqani ndodhet në “Korzo” qendër të qytetit, Komuna Pejë.

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Njësia nr. 49: Barnatorja nr. 2 Gjakovë - ofron për shitje dyqanin në etazh me sipërfaqe të përafërt rreth 218m² sipas listës së asetëve të Ndërmarrjes (204m² sipas matjeve në terren). Lokali gjendet në katin përdhësë të objektit banesor në Rr. Nënë Tereza, në qendër të qytetit të Gjakovës. Toka NUK është pjesë e shitjes.

Njësia nr. 50: NSH Dubrava Objekti i Administratës, Istog - ofron për shitje tokën me sipërfaqe rreth 9ari dhe 4m² (904m²), objektin e administratës dhe lokalin afarist me sipërfaqe totale të përafërt 640m² sipas listës së asetëve të Ndërmarrjes (540m² sipas matjeve në teren). Prona gjendet në rrugën Fasil Ferati në qytetin e Istogut.

Njësia nr.51: Pasuria Bujqësore Toka në Kosinë (Lot B) - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 2ha 14ari 65m², në zonën kadastrale Kosinë, Komuna e Ferizajit, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

Njësia nr.53: Plantacioni Toka në Kosinë - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 2ha 35ari 29m², në zonën kadastrale Kosinë, Komuna e Ferizajit, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

Njësia nr.54: Plantacioni Toka në Shtime - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 2ha 34ari 56m², në zonën kadastrale Shtime, Komuna e Shtimes, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

Njësia nr. 55 – Barnatorja nr. 5 Prishtinë - ofron për shitje lokalin afarist me sipërfaqe totale prej përafërsisht 398 m², nga të cilat 242 m² është përdhësja dhe 156 m² është kati i parë. Lokali afarist gjendet në një pjesë atraktive të Prishtinës, në Rr. "Ilir Konushevci". Nuk ka tokë që do t'i transferohet blerësit të ri.

Njësia nr. 56: Gërmia Shitorja nr. 153 Sheshi Nëna Terezë - përfshinë ë lokalin afarist/shitore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 64 m² cili gjendet në katin përdhësë të objektit banesor në Sheshin Nëna Terezë në Prishtinë. Nuk ka tokë që do ti transferohet blerësit të ri.

Njësia nr.57: Gërmia Shitorja Arka - përfshinë shitoren me sipërfaqe prej përafërsisht 15 m². Aseti gjendet në katin përdhësë në kuadër të ndërtesës disakatëshe për banim në një pjesë atraktive të qendrës së Obiliqit, në rrugën Hasan Prishtina afër Përmendores së Dëshmorëve. Nuk ka tokë që do ti transferohet blerësit të ri.

Njësia 58: NSH "Farmakos" Prizren – Fabrika e kaltërt – ofron për shitje pronën me sipërfaqe të përgjithshme prej 05 ha 98 ari (59800 m²), prej të cilave 1,867 m² evidentohen si ndërtesë dhe 5ha79ari33m² si tokë jopjellore. Prona ndodhet në rrugën "William Walker", Prizren, në kilometrin e 3-të të rrugës magjistrale Prizren–Vërmicë-Morinë. Vërejtje: Sipas informates nga ZKK Prizren pas matjeve të fundit të kryera nga ZKK PZ, sipërfaqja e tokës

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

nuk korrespondon me shënimet në Certifikaten pronësore. Sipërfaqja në gjendjen faktike është 58546m² (5 ha 85 ari 46m²), përderisa sipërfaqja e regjistruar në Certifikatë është 5 ha 98 ari 00 m² (59800 m²). Objektet nuk janë të regjistruara në kopje të planit por vetëm në Çertifikatë.

Njësia nr.59: R. Agushi Toka në Rezhanc - ofron për shitje tokën me sipërfaqe të përgjithshme rreth 1ha 90ari 21m², në zonën kadastrale Rezhanc, komuna Hani i Elezit, e cila është e përshtatshme për kullosa dhe kultivimin e drithërave të ndryshëm.

Njësia nr. 60: NT Agrodukagjini Dyqani i përkohshëm te Qendra Zejtare – përbëhet nga lokali afarist prej materiali të përkohshëm me sipërfaqe të përafërt 70m² (92m² sipas matjeve në terren) që gjendet në Rr. M. Sahara afër Qendrës Zejtare të qytetit të Pejës. Toka NUK është në shitje.

FUND

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org